

Kumbona e së Diellës



Adhurimi i Barinjve - Matthias Stomer, 1632

Përshumëmot Krishtlindjen dhe Vitin e Ri

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT
Nr.11/12, Nëntor - Dhjetor 2023

KRYEVEPRA TË PAPËRLYERA: “L'OSSERVATORE ROMANO” FLET PËR KARDINALIN SIMONI

Në gazetën vatikanase “L'Osservatore Romano”, në rubrikën “Letra nga Drejtori”, i kushtohet një meditim fjalëve të kardinalit shqiptar Ernest Simoni-Troshani. Është rubrika javore, në të cilën shkruan drejtori aktual i gazetës, Andrea Monda. Artikulli mban datën 9 dhjetor 2023.



“Të gjitha qeniet njerëzore janë kryevepra të Zotit”. Ky është fillimi i fjalimit të shkurtër, mbajtur nga kardinali Ernest Simoni në festën shqiptare të organizuar nga Ambasada në Selinë e Shenjtë, më 4 dhjetor (me rastin e festës kombëtare të 28 nëntorit, përvjetorin e Pavarësisë). Këto fjalë më bënë shumë përshtypje kur i dëgjova të shqiptoheshin nga vetë kardinali Simoni dhe m'u kthyen në mendje në festën e Zojës së Papërlyer – shkruan Andrea Monda në gazetën “L'Osservatore Romano”, një ditë pas solemnitetit marian të kremtuar më 8 dhjetor. - Maria është me të vërtetë kryevepra e Zotit, ajo për të cilën Zoti, duke parë krijimin e tij, e pa se “ishite gjë e mirë” (Zan 1,31). Është njeriu ashtu siç duhej dhe duhet të jetë.

Por ka të drejtë kardinali Simoni, të gjithë njerëzit janë një kryevepër. Para së gjithash, ata janë punë: Zoti derdhi djersë, përdori krijimtarinë dhe kujdesin, edhe në detajet më të vogla, në punën e tij “artistike”. E janë një kryevepër, dëshmi sublime artisti, prandaj, çdo ekzemplar i racës njerëzore është unik dhe i papërsëritshëm, i pakrahasueshëm me asnjë ekzemplar tjetër. Qeniet njerëzore nuk prodhohen në seri, por për secilin është përdorur një shabllon, që pastaj është hedhur.

Nuk bën përshtypje vetëm përmbajtja e këtyre fjalëve, por sidomos burimi, autori i asaj deklarate - vijon Andrea Monda komentin e fjalëve të kardinalit Simoni. - Një meshtar shqiptar 95-vjeçar “i mjegullt”, Ernest Simoni, por kur themi “i mjegullt” e kemi fjalën pikërisht për kuptimin e kundërt: në atë “mjegull” gjendet gjithmonë një dritë e fshehtë, gati për t'u zbuluar, për të shpërthyer. I mjegullt së paku

deri më 21 shtator 2014, kur Papa Françesku, gjatë udhëtimit të tij apostolik në Shqipëri, dëgjoi dëshminë prekëse të don Ernestit në Tiranë dhe u përlot. E përqafoi e ia puthi duart dhe dy vjet më vonë e krijoi kardinal.

Tashmë biografia e kardinal Simonit është e famshme: është i vetmi meshtar i gjallë, që dëshmon persekutimin e regjimit të Enver Hoxhës, i cili e shpalli Shqipërinë “shtetin e parë ateist në botë”. Arrestuar në vitin 1963 nga policia komuniste, - përshkruan drejtori i “L'Osservatore Romano”-s jetën e kardinalit shqiptar, të mirënjohur në atdhe - kaloi 27 vjet në burg dhe punë të detyruar, ndërmjet torturave dhe izolimit, deri më 5 shtator 1990. Sapo u lirua nga burg, i fali torturuesit e tij, duke kërkuar mëshirën e Atit Qiellor për ta.

Të gjithë, tha kardinali Simoni, e mes atyre “të gjithëve” ishin edhe torturuesit e tij. Edhe ata, tha më 4 dhjetor, dolën nga duart e Zotit si kryevepra. Deklaratë marramendëse, shkandulluese. Por jemi në kulmin e artit, të artit hyjnor, sepse firma e artistit është falja, aty njihet “dora” e Zotit. Ajo “prekje”, që ende ndihet e gjallë në fjalët e meshtarit 95-vjeçar dhe që e bën atë, në një farë mënyre, “të papërlyer” si Maria, e cila i fali torturuesit e të Birit, duke ndjekur shembullin e fjalëve të Tij të fundit drejtuar Atit nga kryqi. Fjalët e Birit, kryevepër absolute dhe “model i imitueshëm” nga të gjithë njerëzit, kryevepra të Zotit – përfundon reflektimin e tij drejtori i gazetës vatikanase “L'Osservatore Romano”.



Imzot Angelo Massafra OFM
KUR TË VIJË TË GJEJË NGROHTËSINË E
DASHURISË FAMILJARE!

4

La Civiltà Cattolica
GJUNJËZOHEMI PARA NJË FËMIJE NË GRAZHD

5

Papa Françesku
NËSE ASKUSH NUK MË DËGJON MË, ZOTI
AKOMA MË DËGJON

7

Papa Françesku
TOBI, NË KOHËN E GJYQIT,
ZBULON VARFËRINË E TIJ!

11

Redaksia
THIRRJA E KISHËS ËSHTË TË KUMTOJË
UNGJILLIN!

15

Komisionet Drejtësi dhe Paqe të Evropës
TË DREJTAT E NJERIUT JANË UNIVERSALE

17

Imzot Angelo Massafra OFM
TË REFORMOJMË TË SOTMEN,
T'I JAPIM SHPRESË SË ARDHMES

19

CCEE
HAPA TË RINJ PËR NJË KISHË
SINODALE NË EVROPË

20

Imzot Angelo Massafra OFM
PËRKUJTIM I ATË DONAT KURTIT

21

Imzot Angelo Massafra OFM
EDUKIMI KATOLIK

22

Redaksia
SHUGURIMI DIAKONAL I MARTIN BLETA

25

Motrat Stigmatine
LULËZUAN THIRRJET PËR JETËN
FRANÇESKANE STIGMATINE

26

Ndoc Shaben
RESTAUROHET KISHA E ARBËRIT
MONUMENT KULTURE E HISTORIE

27

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXVI, nr. 11/12 (573 - 574) Nëntor - Dhjetor 2023

Revistë Fetaro-Kulturore

Drejtues

Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia:

Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)

Dom Vlash Palaj

Dom Gjovalin Simoni

Xhon Nika (Redaktor Teknik)

Adresa:

Arqipeshkvia Shkodër

Sheshi Gjon Pali II

Tel. 0222-42764 / Fax. 0222-43673

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

www.kishakatolikeshkoder.com



KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT



KUR TË VIJË TË GJEJË NGROHTËSINË E DASHURISË FAMILJARE!

Mesazhi i Krishtlindjes 2023

Festa e Lindjes së Jezu Krishtit kujtohet në mënyrë liturgjike përmes një kënge të lashtë gregoriane, që e paraqet atë brenda historisë së njerëzimit, jo në një kohë të përgjithshme, por të saktë; për të treguar se i Amshueshmi hyn në kohë për të qenë Hyji-me-ne.

Domethënë, jo një Hyj i largët, i paarritshëm, por një Hyj që bëhet konkret në fytyrën e një fëmije, të Fëmijës së Shenjtë të Betlehemit, Jezu Krishtit, Shpëtimtarit tonë. Është e mrekullueshme metodologjia e Hyjit që shoqëron njerëzimin tonë për të ecur me ne: një metodologji nga e cila kemi kaq shumë për të mësuar!

Neve, që synojmë lavdi dhe nderime, Ai na paraqitet në përvuajtërinë e tij, sepse e di se ne “pluhur jemi dhe në pluhur do të kthehemi” (krh. Zan 3,19).

Neve, që dëshirojmë pasuri materiale, Ai na paraqitet në varfërinë e një grazhdi, sepse e di se “në këtë botë nuk prumë asgjë me vete dhe prej saj asgjë nuk do të marrim me vete” (1 Tim 6,7).

Neve, që tregtojmë vlerën e paçmueshme të familjes njerëzore, Ai na paraqitet si Biri i Marisë dhe i Jozefit, sepse - na mësoi - “njeriu do ta lërë të atin dhe të ëmën e vet dhe do të jetojë me gruan e vet e do të bëhen një trup i vetëm” (Zan 2,24).

Neve, vazhdimisht nën shtytjen e tundimit të vetëmjaftueshmërisë dhe të egocentrizmit, Ai na paraqitet si Samaritani i Mirë, sepse - thotë - “doni njëri-tjetrin sikurse unë ju desha ju” (Gjn 15,12).

Neve, të mësuar që të mashtrohemi nga fjalët e panumërta të botës multimediale, Ai na paraqet si “Fjala”, sepse “Fjala u bë njeri dhe jetoj ndër ne” (Gjn 1,14).

Pse në këtë Mesazh i kam vendosur në mënyrë të përsëritur këto paralelizma mes nesh dhe Jezusit? Thjesht sepse kjo festë duhet të na kujtojë jo vetëm rëndësinë e lindjes së Krishtit dhe rëndësinë e saj për historinë e njerëzimit, por duhet të na rikthejë te Ai dhe te mësimet e tij. Them “Krishtlindje”, por disa herë harrojmë se ajo është “lindja e Krishtit”, duke e zbrazur kështu këtë festë nga kuptimi i saj më i thellë.

T'i zbukurojmë rrugët tona, të bëjmë që në ta të tingëllojnë meloditë tipike të kësaj periudhe, por ta kthejmë këtë festë te Krishti: të mos festojmë më pa të Festuarin! Të përgatisim një vend për të në shtëpitë tona, duke zbukuruar zemrat tona me përvuajtërinë e atyre që e dinë se duhet të mirëpresin një mik të rëndësishëm.

T'i përgatisim një vend në tryezat tona të mbushura plot në personin e të varfërve, që, në këtë ditë, të kenë një vakt të ngrohtë.

T'i përgatisim familje që jetojnë dimensionin e

dashurisë, që kur të vijë të gjejë ngrohtësinë e dashurisë familjare, të dashurisë vëllazërore.

T'i përgatisim një botë më njerëzore - të cilën Ai e do aq shumë - duke ndihmuar jo vetëm ata që kanë nevojë, por vetë shoqërinë në të cilën jetojmë, duke mos rënë nën tundimin për t'u arratisur, por duke iu hapur bujarisht angazhimit qytetar.

Dhe në fund, t'i përgatisim një vend edhe në kishat tona. Nuk mjafton ta quajmë veten të krishterë, por, siç na kujton Papa Shën Luani i Madh, “Njihe, o i krishterë, dinjitetin tënd dhe, duke u bërë pjesëmarrës në natyrën hyjnore, mos dëshiro të kthehesh në një sjellje të padenjës”. Nuk mjafton të hyjmë në kishë për të përmbushur një detyrë, por duhet të ushqehemi me Krishtin, Fjalën dhe Bukën, në mënyrë që “Hyji të jetë gjithçka në të gjithë” (1 Kor 15,28).

Këtë vit festojmë tetëqindvjetorin që kur Shën Françesku i Asizit pati intuitën për të rikrijuar mjedisin ku lindi Jezusi dhe i cili, që atëherë, është bërë traditë në kishat dhe në shtëpitë e të krishterëve. Por Françesku nuk u shty nga një impuls thjesht fëmijëror dhe emocional, por nga dëshira për të soditur atë përvuajtëri të Hyjit, i cili “edhe pse me natyrë Hyj, barazinë e vet me Të nuk e çmoi si një visar që s'mundet pa të, por ia mohoi vetvetes e mori natyrën e shërbëtorit dhe u bë i ngjashëm me njerëz” (Fil 2,6-7). Ajo ngjarje e vitit 1223 u kremtua gjatë Meshës, vendi ku Jezu Krishti e bën veten të pranishëm si Fjalë dhe si Bukë.

I bëj thirrje dhe uroj të gjithë të krishterët, që të bëhen të vetëdijshëm për këtë prani të Krishtit në Kishën e tij dhe të mos e injorojnë atë, por ta mirëpresin me pjesëmarrje aktive dhe të përgjegjshme në kremtimet që zhvillohen në të: ato janë një dhuratë që ne marrim; nëse nuk e pranojmë këtë dhuratë nga Zoti do të thotë se refuzojmë vetë Zotin.

Qoftë kjo festë e Lindjes së Jezu Krishtit rasti për një bashkëngjitje të ripërtërirë personale dhe bashkësiore me Të, duke mësuar prej Tij rregullën e dashurisë. Vetëm dashuria mund t'ia ndryshojë fatin kësaj bote, tashmë (për fat të keq!) të mësuar me luftëra dhe kaq shumë vuajtje.

Urimi im më i sinqertë mbërritë tek të gjithë, veçanërisht tek të varfrit, të sëmurët, të burgosurit, tek ata që nuk shpresojnë më në një të ardhme më të mirë: lindja e Krishtit qoftë ngushëllim dhe paqe për të gjithë.

Përshumëvjet të gjithë Katolikëve, Ortodoksëve, të Krishterëve dhe njerëzve vullnetmirë.

Arqipeshkvi Juaj



GJUNJËZOHEMI PARA NJË FËMIJE NË GRAZHD

Misteri i Krishtlindjeve sipas Edith Stein

Në vitin 1958, para vdekjes së Edith Stein, Reinhold Schneider, një shkrimtar gjerman i nivelit të lartë, shkroi: "Tek Edith Stein ka një shpresë të madhe, një premtim për popullin e saj dhe për njerëzit tanë: që kjo figurë e pakrahasueshme të hyjë me të vërtetë në jetën tone. Çfarë kuptoi kjo grua e pakrahasueshme, e lindur në Breslau në 1891, në një familje hebrenjsh ortodoksë, nxënësja e preferuar i Husserl-it dhe më pas asistentja e tij, e konvertuar në katolicizëm në vitin 1922, murgeshë karmelite në 1933, me emrin Teresa Benedikta e Kryqit. Vdiq në dhomat e gazit të Aushvicit në 1942, dhe u shenjtërua në 1998? Ajo që kuptoi na zbulohet nga vepra e saj, veçanërisht *Scientia Crucis*. Studim mbi Shën Gjonin e Kryqit, por gjithashtu, dhe në terma më të thjeshtë dhe më sintetikë, teksti i një prej konferencave të saja, i përpunuar në abacinë benediktine të Beuron-it, gjatë festave të Krishtlindjeve të vitit 1931: *Misteri i Krishtlindjes* (Brescia, Queriniana, 1989). Ai përfshin rreth njëzet faqe, me një ritëm meditues dhe soditës, të mbushur me magjepsje përpara se Fjala të bëhej fëmijë dhe të mbështetur nga një përkushtim i dashur për të jetuar plotësisht pasojat e Krishtit. Asnjë lëshim ndaj retorikës apo sentimentalizmit, por zhytje intensive në një mister që trondit dhe prek. Ne do të shpjegojmë idenë bazë me qëllim që t'i ndihmojmë lexuesit tanë të përjetojnë misterin e Krishtlindjes më me vetëdije.

* * *

Edith Stein, për konferencën e saj, nis nga një vëzhgim i përgjithshëm: «Kur ditët bëhen gjithnjë e më të shkurtra, kur, gjatë një dimri normal, bien fjollat e para të borës, me ndrojtje dhe nënshtrojnë mendimet e para të Krishtlindjeve. Kjo fjalë e thjeshtë nxjerr një bukuri misterioze, së cilës një zemër vështirë se mund t'i shpëtojë. Edhe ata që thonë një besim tjetër dhe jobesimtarët, për të cilët historia e lashtë e Fëmijës së Betlehemit nuk u thotë asgjë, përgatitin festën dhe përpiqen të rrezatojnë një rreze gëzimi aty-këtu. Tashmë javë dhe muaj përpara se një rrjedhë e ngrohtë dashurie të vërshojë gjithë tokën. Një festë dashurie dhe gëzimi, ky është ylli drejt të cilit dynden të gjithë në muajt e parë të dimrit» (f. 23).

Por për të krishterin – vëren menjëherë Stein – festa e Krishtlindjes ka një kuptim tjetër; Këngët dhe tekstet liturgjike të Ardhjes tregojnë këtë: «Zbritni, qiej, nga lart, dhe retë lëshojnë shiun e të Drejtit! Zoti është afër! Le ta duam! Eja o Zot dhe mos vono! Gëzohu, Jerusalem, shkëlqej nga gëzimi, sepse Shpëtimtari yt vjen tek ti! Pastaj antifonat e Magnificatit (O urtësi, o Adonai, o rrënja e Jeseut, o çelësi i Davidit, o Lindje, o Mbret i kombeve) që thërrasin nostalgjikët dhe flakët e tyre "Eja na shpëto!". Në fund Lajmi i gëzueshëm: "Sot do ta dini se Zoti vjen dhe nesër do të sodisni lavdinë e





tij". E. Stein komenton: «Po, kur në mbrëmje pemët e Krishtlindjeve shkëlqejnë dhe ne shkëmbejmë dhurata, një nostalgji e pakënaqur vazhdon të na mundojë dhe të na shtyjë drejt një drite tjetër shkëlqyese, derisa bien kambanat e meshës së mesnatës dhe mrekullia e natës së shenjtë, ripërtërirë në altarë të përmytur me drita e lule. "Dhe Fjala u bë njeri." Atëherë është momenti në të cilin shpresa jonë ndihet e kënaqur me lumturi" (f. 25).

* * *

Përpara se të zhytet në misterin e Krishtlindjes, në vazhden e Ushtrimeve Shpirtërore të Shën Ignacit, Stein përshkruan një vend të përbërë: duke parë vendin dhe personazhet e ngjarjes. Një grazhd dhe në të një fëmijë; gjunjëzohemi dhe dëgjojmë "të rrahurat e zemrës së tij". Pranë tij, Nëna e tij dhe Jozefi: me Nënë e të gjitha Nënave / Ai ruan fëmijën Jezus. Pastaj barinj të mbi të cilët duart e Fëmijës derdhen vesën e hirit, duke i mbushur me gëzim. Edith i sheh gjithashtu mbretërit e shenjtë (të cilët «gjenden në grazhd si përfaqësues të atyre që kërkojnë nga çdo tokë dhe çdo popull»: të pafajshmit e shenjtë, *flores martirum*, lulet e buta të mbledhura para se të piquen për të, realiteti i sakrificës; Shën Shtjefni, "protomartiri, i cili i pari ndoqi Zotin deri në vdekje"; Gjoni, "apostulli i dashurisë".

"Fëmija shtrin duart e tij të vogla në grazhd dhe buzëqeshja e tij tashmë duket se tregon se sa më vonë, kur të bëhet i rritur, buzët e tij do të thonë: "Ejani tek unë, të gjithë ju që jeni të lodhur dhe të etur" [...] . Përpara tyre qëndron nata e ngurtësimit dhe verbërisë së pakuptueshme: skribët, të cilët janë në gjendje të japin informacion për kohën dhe vendin në të cilin do të lindë Shpëtimtari i botës, por që nuk nxjerrin nga këtu asnjë "Le të shkojmë në Betlehem!", dhe mbreti Herod që dëshiron të vrasë Zotin e jetës. Përpara Fëmijës në grazhd shpirtat ndahen. Ai është Mbreti i mbretërve dhe Zoti i jetës dhe i vdekjes, ai thotë "Eja pas meje!", dhe kush nuk është me të është kundër tij. Ai gjithashtu e shqipton atë për ne dhe na vë përpara vendimit për të zgjedhur midis dritës dhe errësirës

* * *

Soditja e shpellës së shenjtë kufizohet me meditimin e misterit të Krishtlindjes. Edith Stein e përmbledh kështu: Fjala është bërë njeri dhe gjendet në

figurën e një Fëmije të porsalindur. Tek ai natyra hyjnore dhe natyra njerëzore ekzistojnë në unitet të përsosur. "O shkëmbim i mrekullueshëm! Krijuesi i gjinisë njerëzore që na jep hyjninë e tij duke marrë një trup. Për këtë punë të mrekullueshme, Shëlbuesi erdhi në botë. Zoti u bë bir njeriu, që njerëzit të bëheshin fëmijë të Perëndisë. Njëri prej nesh e kishte grisur lidhjen e birërisë hyjnore, njëri prej nesh duhej ta lidhte përsëri dhe të paguante për mëkatën. Por asnjë pasardhës i kësaj pasardhësie të lashtë, të sëmurë dhe të bastarduar nuk ishte në gjendje ta bënte këtë. Mbi të duhej të shartohej një degëz e re, e shëndetshme dhe fisnike. Ai është bërë njëri prej nesh, ose më mirë edhe më shumë, sepse është bërë një me ne".

Hyjnizimi i njeriut nëpërmjet mishërimit të Fjalës hap horizonte emocionuese dhe sfiduese. "Ai u bë një trup misterioz me ne: ai kryet i yni, ne gjymtyrët e tij. Nëse i vendosim duart në duart e Fëmijës hyjnore dhe i përgjigjemi me një "po" "Më ndiq" të tij, atëherë ne jemi të tij dhe rruga është e lirë që jeta e tij hyjnore të derdhet në ne". Edith përshkruan pasurinë, shkëlqimin dhe nevojat e kësaj jete hyjnore. Prej tyre ai nxjerr në pah tre, më të ngutshmet. E para, "të qenit një me Perëndinë", duke e lënë Krishtin të jetojë dhe të veprojë në ne. E dyta, "nëse në trupin mistik Krishti është koka dhe ne jemi gjymtyrët, atëherë jemi gjymtyrë të njëritjetrit dhe të gjithë së bashku jemi një gjë në Zotin, një jetë hyjnore". Kjo do të thotë se për të krishterin nuk ka "person të huaj", se dashuria e Krishtit nuk njuh kufij, nuk dështon kurrë, nuk tkurret nga shëmtia dhe fëlliqësia. E treta, "ec duke i dhënë dorën Zotit, bëj vullnetin e Zotit dhe jo vullnetin tënd, vendos çdo shqetësim dhe shpresë në duart e tij, mos u shqetëso më për veten dhe për të ardhmen tënde. Kjo është baza e lirisë dhe gëzimit të fëmijës së Perëndisë".

(La Civiltà Cattolica, 2008)





NËSE ASKUSH NUK MË DËGJON MË, ZOTI AKOMA MË DËGJON

Mesazhi i Atit të Shenjtë Françesku për Ditën Botërore të Rinisë XXXVIII

Romë 14/11/2023

Publikojmë më poshtë tekstin e Mesazhit që Ati i Shenjtë Françesku u dërgoi të rinjve dhe të rejave të botës për Ditën Botërore të Rinisë XXXVIII e kremtuar në kishat e veçanta më 26 nëntor 2023, me temën "Të gëzuar në shpresë" (Rm 12,12)

"Të gëzohemi në shpresë" (Rom 12:12)

Të dashur të rinj!

Gushtin e kaluar takova qindra mijëra bashkëmoshatarë tuaj, nga e gjithë bota, të mbledhur në Lisbonë për Ditën Botërore të Rinisë. Në kohën e pandemisë, mes shumë pasigurive, kishim ushqyer shpresën se kjo festë e madhe e takimit me Krishtin dhe me të rinj të tjerë mund të realizohej. Kjo shpresë u realizua dhe, për shumë prej nesh të pranishëm, përfshirë edhe mua, takimi shkoi përtej çdo pritshmërie! Sa i bukur ishte takimi ynë në Lisbonë! Një përvojë e vërtetë transformimi, një shpërthim drite dhe gëzimi!

Në fund të meshës finale në "Fushën e Hirit", u tregova ndalesën e radhës në pelegrinazhin tonë ndërkontinental: Seul, Kore, në vitin 2027. Por më parë ju lashë një takim në Romë, në 2025, për Jubileun Rinor, ku edhe ju do të jeni "pelegrinët e shpresës".

Ju të rinj, në fakt, jeni shpresa e gëzueshme e një Kishe dhe e një njerëzimi gjithmonë në lëvizje. Do të doja të të merrja për dore dhe të ecja në rrugën e shpresës me ty. Do të doja të flisja me ju për gëzimet dhe shpresat tona, por edhe për trishtimin dhe ankthin e zemrave tona dhe të njerëzimit që vuan (shih Kushtetuta Pastorale Gaudium et spes, 1). Në këto dy vite përgatitje për Jubileun, fillimisht do të meditojmë mbi shprehjen paulinase "Të lumtur në shpresë" (Rm 12,12), dhe më pas do të thellohem më thellë në atë të profetit Isaia: "Ata që shpresojnë në Zotin ecin pa u lodhur" (shih Is 40,31).

Nga vjen ky gëzim?

"Të gëzuar në shpresë" (Rm 12,12) është një nxitje e Shën Palit drejtuar bashkësisë së Romës, i cili gjendet në një periudhë persekutimi të fortë. Dhe në të vërtetë "gëzimi në shpresë", i predikuar nga Apostulli, lind nga misteri i Pashkës së Krishtit, nga fuqia e ringjalljes së tij. Nuk është fryt i përpjekjes, zgjuarsisë apo artit njerëzor. Është gëzimi që vjen nga takimi me Krishtin. Gëzimi i



krishterë vjen nga vetë Zoti, duke ditur se ne jemi të dashur prej Tij.

Benedikti XVI, duke reflektuar mbi përvojën që pati në Ditën Botërore të Rinisë në Madrid në 2011, pyesim veten: «Nga vjen gëzimi? Si e shpjegoni? Sigurisht që ka shumë faktorë që veprojnë së bashku. Por ajo që është vendimtare është [...] siguria që vjen nga besimi: unë jam i kërkuar. Unë kam një detyrë në histori. Jam pranuar, jam i dashur». Dhe ai saktësoi: "Në fund të fundit ne kemi nevojë për mikpritjen pa kushte. Vetëm nëse Zoti më mirëpret dhe unë jam i sigurt për këtë, e di përfundimisht: është mirë që jam atje. [...] Është mirë të ekzistosh si njeri, edhe në kohë të vështira. Besimi të bën të lumtur duke filluar nga brenda" (Adresa në Kurinë Romake, 22 dhjetor 2011).

Ku është shpresa ime?

Rinia është një kohë plot shpresa dhe ëndrra, e ushqyer nga realitetet e bukura që pasurojnë jetën tonë: shkëlqimi i krijimit, marrëdhëniet me të dashurit dhe miqtë tanë, përvoja artistike dhe kulturore, njohuri shkencore dhe teknike, nisma që promovojnë paqen, drejtësinë dhe vëllazërinë, e kështu me radhë. Ne jetojmë, megjithatë, në një kohë në të cilën për shumë njerëz, madje edhe për disa të rinj, shpresa është një mungesë e madhe. Fatkeqësisht, shumë nga bashkëmoshatarët tuaj, po



përrjetojnë përvoja lufte, dhune, bullizmi dhe forma të ndryshme vështirësish, janë të prekur nga dëshpërimi, frika dhe depresioni. Ata ndjehen sikur janë mbyllur në një burg të errët, të paafte për të parë rrezet e diellit. Kjo demonstron në mënyrë dramatike nga shkalla e lartë e vetëvrasjeve tek të rinjtë në disa vende. Në një kontekst të ngjashëm, si mund ta përrjetojmë gëzimin dhe shpresën për të cilën flet Shën Pali? Përkundrazi, rrezikon që dëshpërimi të mbizotërojë mendimin, se është e kotë të bësh mirë, sepse askush nuk do ta vlerësonte dhe njohë (të mirën që bën), siç lexojmë në Librin e Jobit: «Ku është, pra, shpresa ime? Kush do ta shohë të mirën time?» (Jobi 17,15).

Përballë tragjedi të njerëzimit, veçanërisht vuajtjeve të të pafajshmëve, edhe ne, teksa lutemi në disa Psalme, pyesim Zotin: "Pse?". E pra, ne mund të jemi pjesë e përgjigjes së Zotit. Ne, të krijuar nga Ai në shëmbëlltyrën dhe ngjashmërinë e tij, mund të jemi një shprehje e dashurisë së tij që lind gëzim dhe shpresë edhe aty ku duket e pamundur. Më vjen ndërmend protagonistin e filmit "Jeta është e bukur", një baba i ri, i cili me delikatesë dhe imagjinatë arrin ta shndërrojë realitetin e ashpër në një lloj aventurë dhe lojë, duke i dhënë kështu djalit të tij "sy shpresë". Nga tmerret e kampit të përqendrimit, duke ruajtur pafajësinë e tij dhe duke parandaluar ligësinë njerëzore që t'i vjedhë të ardhmen. E pra nuk janë vetëm histori të sajara! Kjo është ajo që ne shohim në jetën e shumë shenjtërve, të cilët ishin dëshmitarë të shpresës edhe në mes të ligësisë më mizore njerëzore. Po të shohim Shën Maximilian Maria Kolbe, Shën Josephine Bakhita, ose bashkëshortët të lum Józef dhe Eiktoria Ulma me shtatë fëmijët e tyre.

Mundësia e ndezjes së shpresës në zemrat e njerëzve, nisur nga dëshmia e krishterë, u theksua me mjeshtëri nga Shën Pali VI, kur na kujtoi: «Një i krishterë ose një grup të krishterësh, brenda

bashkësisë së njerëzve në të cilët jetojnë, [...] ata rrezatojnë në një mënyrë shumë të thjeshtë dhe spontane besim në disa vlera që janë përtej vlerave aktuale, dhe shpresë në diçka që nuk mund të shihet dhe që njeriu nuk do të guxonte ta imagjinonte» (Apostolic Exhortation Evangelii nuntiandi, 21).

Shpresa "e vogël".

Poeti francez Charles Péguy, në fillim të poemës së tij mbi shpresën, flet për tre virtytet teologjike - besimin, shpresën dhe bamirësinë - si tre motra që ecin së bashku:

"Shpresa e vogël përparon mes dy motrave të saj të mëdha dhe as që vihet re. [...]

Është ajo, e vogla, që tërhiq zvarrë çdo gjë.

Sepse besimi sheh vetëm atë që është.

Dhe ajo sheh se çfarë do të jetë.

Bamirësia e do vetëm atë që është.

Dhe ajo, ajo e do atë që do të jetë.

[...]

Është ajo që i bën të ecin dy të tjerët.

Dhe çfarë i shtyn ata.

Dhe kjo i bën të gjithë të ecin"

(Portiku i misterit të virtytit të dytë, Milano 1978, 17-19).

Unë jam gjithashtu i bindur për këtë karakter modest, "të vogël", por themelor të shpresës. Mundohuni të mendoni: si mund të jetonim pa shpresë? Si do të ishin ditët tona? Shpresa është kripa e përditshmërisë.

Shpresa, dritë që shkëlqen natën

Në traditën në treditëshen e Pashkëve, e Shtuna e Madhe është dita e shpresës. Midis të Premtes së Madhe dhe të Dielës së Pashkëve, është si një rrugë e mesme midis dëshpërimit të dishepujve dhe gëzimit të tyre të Pashkëve. Është vendi ku lind shpresa. Kisha, atë ditë, në heshtje përkujton zbritjen e Krishtit në ferr. Mund ta shohim të paraqitur në formë pikturë në shumë ikona.

Ata na tregojnë Krishtin që flakëron nga drita që zbret në errësirën më të thellë dhe kalon nëpër të. Është kështu: Hyji nuk e kufizon veten të shikojë me dhembshuri zonat tona të vdekjes ose të na thërrasë nga larg, por hyn në përvojat tona të ferrit si një dritë që shkëlqen në errësirë dhe e mposht atë (shih Gjoni 1:5). Një poezi në gjuhën Xhosa të Afrikës së Jugut e shpreh mirë: «Edhe sikur shpresat të kenë mbaruar, me këtë poezi zgjoj shpresën. Shpresa ime zgjohet sepse shpresoj te Zoti. Shpresoj se do të bashkohemi! Qëndroni të fortë në shpresë, sepse rezultati i mirë është afër."

Kjo, po ta mendojmë mirë, ishte shpresa e





Virgjëreshës Mari, e cila qëndroi e fortë nën kryqin e Jezusit, e sigurt se "rezultati i mirë" ishte afër. Maria është gruaja e shpresës, Nëna e shpresës. Në Kalvar, "e palëkundur në shpresë kundër çdo shprese" (Rom 4:18), ajo nuk la që siguria e Ringjalljes së shpallur nga Biri i saj të vdiste në zemrën e saj. Është ajo që e mbush heshtjen e së Shtunës së Madhe me një pritje të dashur plot shpresë, duke rrënjosur te dishepujt sigurinë se Jezusi do ta mposhtte vdekjen dhe se e keqja nuk do të ishte fjala e fundit.

Shpresa e krishterë nuk është një optimizëm i lehtë dhe nuk është diçka për mendjelehtët: është siguria, e rrënjosur në dashuri dhe besim, se Zoti nuk na lë kurrë vetëm dhe e mban premtimin e tij: «Edhe nëse kaloj nëpër një luginë e hijes së vdekjes, s'trembem nga e keqja, sepse ti je me mua» (Ps 23:4). Shpresa e krishterë nuk është mohimi i dhimbjes dhe vdekjes, është një festë e dashurisë së Krishtit të Ngjallur që është gjithmonë me ne, edhe kur duket larg. «Vetë Krishti është për ne drita e madhe e shpresës dhe e udhëzimit në natën tonë, sepse Ai është "ylli rrezatues i mëngjesit"» (Kërkesa Apostolike Christus vivit, 33).

Të ushqejmë shpresën

Kur tek ne është ndezur shkëndija e shpresës, ndonjëherë ekziston rreziku që ajo të mbytet nga shqetësimet, frika dhe detyrat e jetës së përditshme. Por një shkëndijë ka nevojë për ajër që të vazhdojë të shkëlqejë dhe të ringjallet në një zjarr të madh shprese. Dhe është flladi i ëmbël i Shpirtit Shenjtë që ushqen shpresën. Ne mund të bashkëpunojmë për ta ushqyer në mënyra të ndryshme.

Shpresa ushqehet nga lutja. Duke u lutur ne ruajmë dhe ripërtërijmë shpresën. Duke u lutur ne mbajmë të gjallë shkëndijën e shpresës. «Lutja

është forca e parë e shpresës. Ju luteni dhe shpresa rritet, ajo shkon përpara» (Catechesis, 20 maj 2020). Të lutesh është si ngjitja në një lartësi të madhe: kur jemi në tokë, shpesh nuk mund ta shohim diellin sepse qielli është i mbuluar me re. Por nëse ngrihemi mbi retë, drita dhe nxehtësia e diellit na rrethojnë; dhe në këtë përvojë gjejmë sigurinë se dielli është gjithmonë i pranishëm, edhe kur gjithçka duket gri.

Të dashur të rinj, kur ju rrethon mjegulla e dendur e frikës, e dyshimit dhe e shtypjes dhe nuk e shihni më diellin, merrni rrugën e lutjes. Sepse "nëse askush nuk më dëgjon më, Zoti akoma më dëgjon" (Benedikti XVI, Encyclical Letter Spe salvi, 32). Kur ndeshemi me ankthet dhe na sulmojnë, le të

gjejmë çdo ditë kohë për të pushuar në Zotin: "Shpirti im pushon vetëm në Zotin, prej tij vjen shpresa ime" (Ps 62,6).

Shpresa ushqehet nga zgjedhjet tona të përditshme. Ftesa për t'u gëzuar në shpresë, që Shën Pali u drejton të krishterëve të Romës (shih Rom 12:12), kërkon zgjedhje shumë konkrete në jetën e përditshme. Prandaj ju bëj thirrje që të zgjidhni një mënyrë jetese të bazuar në shpresë. Më lejoni t'ju jap një shembull: në mediat sociale duket më e lehtë të ndash lajme të këqija sesa lajme shpresëdhënëse. Prandaj, ju bëj një propozim konkret: përpikuni të ndani një fjalë shprese çdo ditë. Bëhuni mbjellës shprese në jetën e miqve tuaj dhe të gjithëve përreth jush. Në fakt, «shpresa është e përlulur dhe është një virtut mbi të cilin punohet – si të thuash – çdo ditë [...]. Çdo ditë është e nevojshme të kujtojmë se ne kemi depozitën, që është Shpirti, i cili vepron në ne me gjërat e vogla» (Meditim i mëngjesit, 29 tetor 2019).

Ndizni pishtarin e shpresës

Kur dilni ndonjëherë (në mbrëmje) me miqtë tuaj dhe, nëse është errësirë, merrni smartphone-t dhe ndizni blicin për të hedhur dritë. Edhe në koncerte të mëdha, mijëra të rinj lëvizin këto drita moderne në ritmin e muzikës, duke krijuar një skenë tërheqëse. Natën, drita na bën t'i shohim gjërat në një mënyrë të re, madje edhe në errësirë shfaqet një dimension bukurie. Kështu është me dritën e shpresës që është Krishti. Prej tij, nga ringjallja e tij, na ndriçohet jeta. Me Të ne shohim gjithçka në një dritë të re.

Thuhet se kur njerëzit iu afruan Shën Gjon Palit II për të biseduar me të për një problem, pyetja e tij e parë ishte: "Si shfaqesh në dritën e besimit?" Edhe një vështrim i ndriçuar nga shpresa i bën gjërat të



duken në një dritë tjetër. Prandaj, ju ftoj ta adoptoni këtë vështrim në jetën tuaj të përditshme. I gjallëruar nga shpresa hyjnore, i krishteri e gjen veten të mbushur me një gëzim tjetër, që vjen nga brenda. Sfidat dhe vështirësitë janë aty dhe do të jenë gjithmonë, por nëse jemi të pajisur me një shpresë "të mbushur me besim", ne i përballim duke e ditur se ato nuk e kanë fjalën e fundit dhe ne vetë bëhemi një pishtar i vogël shprese për të tjerët.

Secili prej jush mund të jetë gjithashtu i tillë, në masën që besimi juaj të bëhet konkret, duke iu përmbajtur realitetit dhe historive të vëllezërve dhe motrave tuaja. Le të mendojmë për dishepujt e Jezusit, të cilët një ditë, në një mal të lartë, e panë atë duke ndriçuar me dritë madhështore. Po të kishin qëndruar atje lart, do të ishte një moment i bukur për ta, por të tjerët do të kishin mbetur jashtë. Ishte e nevojshme që ata të zbrisnin. Ne nuk duhet të ikim nga bota, por ta duam kohën tonë, në të cilën Zoti na ka vendosur jo pa arsye. Ne mund të jemi të lumtur vetëm duke ndarë hirin e marrë me vëllezërit dhe motrat që Zoti na jep çdo ditë.

Të dashur të rinj, mos kini frikë ta ndani me të gjithë shpresën dhe gëzimin e Krishtit të Ngjallur! Shkëndijën që ju ka ndezur, ruajeni, por në të njëjtën kohë dhurojeni: do ta kuptoni se do të rritet edhe më shumë në ju! Shpresën e krishterë nuk mund ta mbajmë për vete, si një ndjenjë të bukur,

sepse ajo është e destinuar për të gjithë. Qëndroni afër veçanërisht me ata miq tuaj që mund të duken të buzëqeshur, por brenda janë duke qarë, me mungesë shprese. Mos lejoni që të infektoheni nga indiferenca dhe individualizmi: qëndroni të hapur, si kanale në të cilat shpresa e Jezusit mund të rrjedhë dhe të përhapet në mjediset ku jetoni.

"Krishti jeton. Ai është shpresa jonë dhe rinia më e bukur në këtë botë!" (Kërkesa Apostolike *Christus vivit*, 1). Kështu ju shkrova gati pesë vjet më parë, pas Sinodit të Rinisë. Ju ftoj të gjithëve, veçanërisht ata që janë të përfshirë në shërbimin për të rinjtë, të marrin përsipër Dokumentin Përfundimtar të vitit 2018 dhe Nxitjen Apostolike *Christus vivit*. Ka ardhur koha që së bashku të bëjmë një bilanc të situatës dhe të punojmë me shpresë për zbatimin e plotë të atij Sinodi të paharrueshëm.

Le t'ia besojmë gjithë jetën Marisë, Nënës së Shpresës. Ajo na mëson ta mbajmë Jezusin, gëzimin dhe shpresën tonë, brenda nesh dhe t'ua japim të tjerëve. Udhëtim të mbarë, të dashur të rinj! Ju bekoj dhe ju shoqëroj me lutje. Dhe mos harro lutu edhe ti për mua!

*Romë, San Giovanni in Laterano,
9 nëntor 2023*



TOBI, NË KOHËN E GJYQIT, ZBULON VARFËRINË E TIJ!

*Mesazhi i Atit të Shenjtë Françesku
-Dita viti botërore për të varfërit-*

Dt.19 nëntor 2023

«Mos e mënjano faqen tënde nga asnjë skamnor» (Tb 4, 7)

1. Dita Botërore e të Varfërve, një shenjë e frytshme e mëshirës së Atit, vjen për të shtatën herë për të mbështetur udhëtimin e komuniteteve tona. Është një takim që gradualisht Kisha po zë rrënjë në kujdesin e saj baritor, për të zbuluar gjithnjë e më shumë përmbytjen qendrore të Ungjillit. Çdo ditë jemi të përkushtuar për të mirëpritur të varfërit, por kjo nuk është e mjaftueshme. Një lumë varfërie përshkon qytetet tona dhe bëhet gjithnjë e më e madhe; ai lumë duket se na pushton, sa thirrja e vëllezërve dhe motrave që kërkojnë ndihmë, mbështetje dhe solidaritet rritet gjithnjë e më shumë. Për këtë arsye, të dielën para festës së Jezu Krishtit Mbretit të Universit, mbledhemi rreth Tryezës së tij për të marrë përsëri prej Tij dhuratën dhe angazhimin për të jetuar varfërinë dhe për t'u shpërbërë me varfërinë.

«Mos e mënjano faqen tënde nga asnjë skamnor» (Tb 4,7). Kjo Fjalë na ndihmon të kuptojmë thelbin e dëshmisë sonë. Duke u fokusuar në Librin e Tobias, një tekst pak i njohur i Beslidhjes së Vjetër, bindëse dhe plot urtësi, do të

na lejojë të hyjmë më mirë në përmbytjen që autori i shenjtë dëshiron të transmetojë. Para nesh hap një skenë të jetës familjare: një baba, Tobi, përshëndet djalin e tij, Tobia, i cili është gati të nisë një udhëtim të gjatë. Tobi duke qenë i vjetër ka frikë se ai kurrë nuk do të jetë në gjendje për të parë përsëri djalin e tij dhe për këtë arsye i lë atij testamentin e tij “shpirtëror”. Ai ishte një i dëbuar në Ninive dhe tani është i verbër, prandaj është dyfish i varfër, por gjithmonë ka pasur një siguri, të shprehur nga emrin që mbanë: “Zoti ka qenë e mira ime”. Ky njeri, i cili ka besuar gjithmonë në Zotin që është një Atë i mirë, dëshiron të lërë djalit jo aq shumë të mira materiale, por dëshminë e rrugës për të ndjekur jetën, prandaj ai i thotë: «Çdo ditë, biri im, kije Hyjin në mendje. Mos dëshiro kurrë të mëkatosh e t'u shmangësh urdhërimeve të tija. Bëj vepra të mira çdo ditë të jetës sate dhe ruaju e mos shko udhëve të padrejtësisë» (4.5).

2. Siç mund të shihet menjëherë, kujtesa që Tobi i vjetër i kërkon djalit të tij nuk kufizohet në një akt të thjeshtë kujtese ose një lutje që i drejtohet Zotit. Ai i referohet gjesteve konkrete që konsistojnë në kryerjen e veprave të mira dhe të jetuarit me drejtësi. Kjo nxitje është edhe më i specifikuar:





«Për të gjithë ata që praktikojnë drejtësinë bëj lëmoshë me pasuritë e tua, dhe duke bërë lëmoshën, syri yt te mos kenë keqardhje» (cfr 4,7).

Fjalët e këtyre reshtave kaq te vjeter befasojn jo pak. Le të mos harrojmë, në fakt, se Tobi humbi shikimin menjëherë pasi kishte kryer një akt mëshire.

Siç thotë ai vetë, që në moshë të re kishte kushtuar jeten e vetë për vepra të bamirësisë: « U kam dhënë shumë lëmoshë vëllezërve të mi dhe bashkatdhetarëve të mi që kanë qenë të humbur bashkë me mua në robëri në Ninivë, në dheun e asirëve. [...] Bukën time e ndaja me të uriturit, petka u jepja të zhveshurve dhe, kur shihja ndokënd të vdekur, të hedhur pas mureve të Ninives që ishte bashkëkombës i mi, e varrosja» (1,3.17).

Ipeshkvijtë evropianë panë gjithashtu me shqetësim skenarët e luftës: atë në Ukrainë që është tashmë në vitin e dytë, situatën në “Nagorno Karabakh” dhe konfliktin në Tokën e Shenjtë, duke përsëritur jo-në e tyre ndaj luftës dhe duke ripërtërirë apelin për një armëpushim përfundimtar, për të vazhduar me lirin e pengjeve dhe për të mbajtur të hapur korridoret humanitare në Gaza.

Gjatë seancës plenare, kardinali Mario GRECH, sekretar i përgjithshëm i Sinodit, trajtoi temën e shërbesës ipeshkvore në një Kishë sinodale, ndërsa kardinali Jean-Claude HOLLERICH, SJ, relator i përgjithshëm i Sinodit, foli për rolin e strukturave mbi kombëtarë në rrugëtimin sinodal. Kardinali Grzegorz RYŚ, arqipeshkëv i Łódź, paraqiti raportin e grupit të punës për përditësimin e Charta Ecumenica, dokumenti i bashkëveprimit mes Kishave të krishtera në Evropë, i nënshkruar nga CCEE-ja dhe CEC në 2001.

Në përfundim të punimeve, ipeshkvijtë vendosën në unanimitet për transferimin e selisë së CCEE-së nga San Gallo (Zvicër) në Romë gjatë vitit 2024 dhe, në të njëjtën kohë, shprehën mirënjohje për Kishën në Zvicër, dhe në veçanti për dioqezën San Gallo, për mirëpritjen dhe bujarinë me të cilën kanë shoqëruar punën e Sekretariatit të CCEE-së në gjithë këto vite. Anëtarët e CCEE-së zgjatën edhe për një vit mandatin e dom Martin MICHALIČEK si sekretar i përgjithshëm i CCEE-së, detyrë në të cilën u thirr në vitin 2018.

Asambleja plenare e radhës do të mbahet në Beograd nga 24 deri më 27 qershor 2024, me ftesë të arqipeshkvit Ladislav NEMET, Zëvendës President i CCEE-së.

Valeta, 30 nëntor 2023





ATË DONATI E KALOI JETËN DUKE KRONTRIBUE PËR KULTURËN

Përkujtim i atë Donat Kurtit (1903-1983) në 120 vjetorin e lindjes

Kuvendi Françeskan, Shkodër

më 9 dhjetor 2023

Të ndëruar pjesëmarrës, të nderuar familjarë të Atë Donat Kurtit, të ndëruar autoritete politike, i nderuar p. Pashko!

Shpreh gëzimin tim që ndodhem këtu në këtë përkujtim të personalitetit të Atë Donat Kurtit ndër fretërit më të shquar të Provincës Françeskane dhe ndër njërzit më të shquar të kulturës shqiptare. Atë Donati e kaloi jetën duke dhënë kontribute në përmirësimin e jetës shpirtërore dhe për ngritjen e disa fushave kulturore të vendit tonë. Atë Donat Kurti ishte një shembull shumë i mirë si frat për kohën që jetoi, ishte një pedagog i çmuar dhe bashkëpunoi me revistën Hylli i Dritës dhe me revistën Zani i Shna Ndout. U shqua në mbledhjen dhe në dokumentimin e zakoneve, e dokeve dhe të traditave tona shumë të lashta. Meritojnë një vëmendje të veçantë tri vëllimet me Prralla

Kombtare, ku në mënyrë të përsosur paraqesin urtësinë dhe mënësinë e popullit tonë. Po kështu mbledhi dhe botoi veprën *Lojë të kombtare* e sidomos veprën postume *Zakone e Doke shqiptare*. Ishte bashkëautorë me të lumin At Bernardin Palaj në botimin e veprës *Kangë Kreshnikësh*. Këto vepra janë një monument i gjallë dhe i pazëvendësueshëm për të studiuar psikologjinë, prejardhjen, traditat dhe zakonet tona.

Në moshën shumë të re, pra kur ishte 42 vjeç ai u burgos e kaloi 17 vite shumë të vështira nëpër burgje dhe kampe të internimit. Vuajti shumë, por nuk u braktiti në vuajtje, jetoi me shpresë në Zotin se idealet e tij që i dëshmoi janë më të forta dhe më të vërteta se vuajtjet që po i shkakttoheshin. I kujton në poezitë e tij, hekurat, tortura, mungesen e ushqimit e punën nëpër kanale e kënetat dhe aty del në pah qëndresa e tij për të mos u mpshtur nga rrethanat e kohës.

Është një punë shumë e mirë që keni botuar 7 vëllimet të Atë Donat Kurtit. Ndër këto vepra spikat vëllimi i tretë me përralla, përkthimi katër Ungjijve dhe i Veprave të Apostujve, dhe vëllimet e tjera ku në qendër të tyre trajtohen disa tema, ajo e edukimit, tema kulturore të përgjithshme dhe aspekte të tjera kulturore e shpirtërore. Patër Doanti ka bërë disa përkthime të teksteve religjioze që presin dritën e botimit. Siç shihet këtu në këtë ekspozitë ka shkrime të tjera që nuk janë botuar. Ftoj fretërit që t'i botojnë të gjitha shkrimet e pater Donati. Kanë vlera gjuhësore, shërbejnë për rritjen shpirtërore dhe janë dëshmi e gjallë e një njeriu që jetoi për Zotin e për Kombin. Nuk u përkulë kurr përpara torturave, urrejtjes, persekutimit por jetoi jetën pa danga edhe pse në varfëri të plotë, dhe duke punuar për vendin tonë. Shumë nga bashkëvëllezërit meshtarë të Atë Donat Kurtit i nderojmë të Lumë që e dhanë jetën për Zotin dhe për kombin.

Ju përgëzojë të gjithëve për këtë organizim dhe Konferencë të frytshme.

Atë Donat Kurti nga qielli bashkë me Martirët luten për ne.

Imzot Angelo Massafra, O.F.M.





EDUKIMI KATOLIK KA QENË QYSH NË KRYE TË HERËS URA E KOMUNIKIMIT

Kontributi i edukimi katolik, pararendës i vlerave evropiane në Shqipëri

Tirana, 6 dhjetor 2023

Që me krijimin e institucioneve të para arsimore nga kongregatat e ndryshme katolike, në trojet arbërore, atëherë të pushtuara prej perandorisë Osmane, erdhi për herë të parë ajo literaturë shkollore e vendeve evropiane. Kolegji Saverian, nëpërmjet profesorëve shqiptarë e të huaj që patën përfunduar studimet jashtë, në Itali dhe Austro-Hungari kryesisht dhe në Bosnia Erzegovine, sollën dhe përkthyen për nxënësit arbër tekstet e tyre studimore. Me implementimin e mëvonshëm të tipografisë së Zojës së Papërlyeme, u bë i mundur shtypi dhe shpërndarja masive e këtyre teksteve, çka krijoi për të parën herë një konvergencë me Evropën e kohës, vlerat e së cilës kishin filluar të kristalizoheshin në parimet bazë që vetëm pas Luftës II Botërore, do të shërbenin si themel i Bashkimit Evropian. Nuk duhet harruar as se si koncepti i patriotizmit në shkolla erdhi si kontribut i drejtpërdrejtë i atë Gjergj Fishtës kur si drejtor i gjimnazit Illyricum, vendosi gjuhën shqipe si gjuhë bazë mësimi.

Por nëse shkojmë më para, atëherë kur koncepti i një Evrope të bashkuar nuk ekzistonte, në mesjetën e hershme dhe atë të mëvonshme, do të shohim se si ajo çfarë vendet e zhvilluara, qytete, shtete e mbretëri të kohës, quanin shkollë, kishte simotra edhe në trojet tona, pranë qelave të famullive. Fjala bie në Pllanë, që në shekullin XVII, gjendej një strukturë e tillë edukimi dhe formimi për banorët e zonës. Edhe në Shtubëll (Kosovë) gjendet dokumentacion që në shekullin e XVII

Edhe humanistët si Gazulli apo Maruli, Beçikemi apo Barleti u formësuan në institucione edukimi katolike, të vetmet atëbotë, dhe kështu dhanë kontributin e tyre në atë çka i shërbeu si taban rilindjes evropiane, disa syresh si fjala bie Barleti, pa e harruar për asnjë moment vendin amë.

Pas listimit të këtyre fakteve historike,

kryesoret por jo të vetmet, arrijmë në përfundimin se lidhjet më të hershme mes Shqipërisë dhe Evropës si dhe kanalet e para nëpërmjet të cilave Evropa i komunikonte vlerat e veta shqiptarëve apo shqiptarët kontribuonin në krijimin e vlerave evropiane, të gjitha këto pra kanë ndodhur falë, nëpërmjet apo me anë të edukimit katolik. Sepse falë këtij edukimi, nuk synohet, ashtu sikurse as tani nuk synohet, vetëm tejçimi i dijeve apo fitimi i tyre, por edhe ndërtimi i një ambienti ku kushdo



plotësohet, ashtu sikurse kërkon edhe thelbi i vlerave edukuese që Evropa propozon.

Një hapësirë ku më së miri u ndërtua ky ambient mbetet Kolegji Saverian, sjellësi i shumë e shumë risive në Shqipëri, mes të cilave edhe sporteve (duke lidhur për herë të parë edukimin fizik me edukimin në tërësi, njëllëj si vendet e tjera me sisteme arsimore të konsoliduar) apo laboratorët eksperimentalë dhe kërkimore. Nën këtë dritë, mundësitë për njohjen e vlerave evropiane sa vinin e zgjeroheshin dhe nxënësit, pasi i njohën këto vlera, i bënë pjesë të tyre, i zotëruan, deshën t'i zbatojnë, por komunizmi e ndërpreu këtë iniciativë e cila do t'ja kishte ndryshuar përgjithmonë fatin dhe fytyrën Shqipërisë. Shkrimet e shumta që në Hylli i Dritës, Posta e Shqypniës etj., atë Fishta, atë



Harapi apo i lumi dom Lazër Shantoja shkruanin, polemizonin me instancat shtetërore pikërisht për të krijuar mundësinë e një qasjeje më evropiane në arsim.

Gjatë 45 viteve të komunizmit, produkti shkencor i shkollave katolike u përdor, pa u cituar asnjëherë, shpesh edhe si plagjaturë, për ngritjen e disa disiplinave shkencore. Sistemi, pavarësisht se i linte në një rang më të ulët se të besuarit e vet, ishte i detyruar që të ftonte herë pas here nxënës të këtyre shkollave, tani burra e gra, për të dhënë mendimin e tyre lidhur me iniciativat e reja, por kur vërejtë se ata do t'i kishte kundër politikave për kultin e individit, i largoi dhe u hoqi çdo të drejtë për të pasur një zë publik lidhur me këto çështje apo çfarëdolloj çështjeje tjetër.

Pas ardhjes së demokracisë, meshtarët e motrat e mbetur synuan ta rilidhnin fillin e shkëputur të edukimit katolik, ftuan të riktheheshin vëllezërit nga kongregata që ishin përzënë, erdhën edhe kongregata të reja dhe edukimi katolik po rilindte, njëlloj si edhe feja, sepse njerëzit e donin, e kishin kërkuar për 45 vjet... Dhe kjo ndodhi! Institucionet e edukimit katolik u ri ngritën, edhe më të forta se më para, dhe akoma sot vijojnë ta mbajnë të hapur atë linjë komunikimi me Evropën, njëlloj si dekada, në mos shekuj më parë.

Rregulltarët dhe Rregulltarët që hapen shkollat katolike në Shqipëri kanë ndjekur në fushën e edukimit duke bazuar plotësisht në Dokumentin e Konkilit të Dytë të Vatikanit “Gravissimum Educationis”. Në këtë dokument Etërit Konkiliarë ofruan disa drejtime-udhëzime bazë të cilat më

pëlqen t'i përmbledh shkurtimisht. Në Dokumentin e sipërpërmendur, pasi përcaktohet parimi sipas të cilit edukimi është një e drejtë themelore për të gjithë njerëzit, kalohet në përshkrimin e natyrës së formimit të të krishterit si një qenie njerëzore që, reflekton vlerat ungjillore, përmes së cilave ai kualifikon angazhimin e tij në shoqërinë njerëzore. Dokumenti, para se të trajtojë tipologjitë formuese, paraqet detyrën parësore që prindërit kanë në edukimin e fëmijëve të tyre, duke iu drejtuar drejtpërdrejtë institucioneve që, në bazën e parimit të subsidiaritetit, duhet të jetë krah prindërve dhe familjeve në këtë mision edukues.

Vetëm në një hap të dytë, Gravissimum Educationis merr në konsideratë agjencitë formuese, si shkolla, e cila, “pjek aftësitë intelektuale, zhvillon aftësinë e gjyqimit, vendos në kontakt me trashëgiminë kulturore të marrë nga brezat e mëparshëm, promovon kuptimin e vlerave, përgatit për jetën profesionale, bën të lindë një lidhje miqësie ndërmjet nxënësve me karaktere dhe kushte të ndryshme sociale, duke favorizuar kuptimin e ndërsjellët ” (GE 5). Edhe në këtë rast thirrja ndaj institucioneve është e fortë, veçanërisht për sa i përket subvencionimeve të drejta në ndihmë të familjeve si dhe respektimit të lirisë së zgjedhjes për edukimin e fëmijëve; si dhe në garantimin për besimtarët e çdo feje për një formim të drejtë dhe të përshtatshëm që nuk cenon besimin e tyre. Për sa i përket shkollës katolike, shkruhet në këtë Dokument: “Sikurse shkollat e tjera ajo përndjek finalitetin kulturor tipik të shkollës si dhe formimin njerëzor të të rinjve. Por elementi i saj më

karakteristik është t'i japë jetë një ambienti komunitar shkollor të përshkuar nga shpirti ungjillor i lirisë dhe të dashurisë hyjnore, të ndihmojë adoleshentët që në zhvillimin e personalitetit të tyre të rriten bashkë, si Krijesa të Reja, që janë bërë me marrjen e Pagëzimit, dhe të bashkërendojë kështu të gjithë kulturën njerëzore me një mesazh shëlbimi në mënyrë që njohja e botës, e jetës, e njeriut që nxënësi dalëngadalë përvetëson, të ndriçohet nga feja” (GE 8).





Në këtë kohë, kur shoqëria paraqet me një shpejtësi të rrufeshme sfida të reja dhe pret nga shkollat zgjidhje të reja, edukimi katolik vazhdon të qëndroje në pararojë të përgjigjes sa më të shpejtë, duke ndjekur shembujt më të mirë evropian, nën frymëzimin e Ungjillit dhe sipas udhëzimeve të Paktit Edukativ Global, të shpallur nga Papa Françesku. Vete Papa Françesku na ka vene në dukje se e sotmja është koha e katastrofës edukative dhe si e tillë nuk mund të lere indiferente askënd. Aderimi ynë si Kishë dhe në veçanti i Edukimit katolik, në aktualizimin e këtij Pakti është i vazhdueshëm dhe kjo konkretizohet, jo vetëm në përpjekjet për rritjen e komuniteteve shkollore (stafeve, prindërve nxënësve) për kah profesionalizmi apo në formimin e tyre etik dhe shpirtëror por edhe në angazhim të shtuar të institucioneve tona për të punuar në rrjet, për të përfshirë familjen dhe institucionet në procesin e edukimit që është shumë më tepër se ai i arsimimit.

Prandaj ne e shohim gjithpërfshirjen në lirinë për të zgjedhur mes pluralitetit të ofertave edukative, jo si realizim të diçkaje të mundshme, por si realizim të diçkaje të domosdoshme falë së cilës, do të mund t'i afrohem më shumë Evropës, në kartën e principeve të së cilës qëndron kjo liri.

Të nderuar! Edukimi katolik ka qenë qysh në krye të herës ura e komunikimit të vlerave evropiane në shoqërinë shqiptare, madje nuk e

teproj nëse them se atëherë kur kombi nuk ekzistonte si ide, falë edukimit katolik është ndërtuar vetëdijesimi për përkatësinë e kujt do në këtë shoqëri. Prandaj edhe ky takim sot, edhe aktivitetet e mëhershme e të mëvonshme që Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar në bashkëpunim me shkollat, kopshtet e gjimnazet realizon, janë tulla në kullën e një edukimi të qëndrueshëm përballë gjithçkaje dhe të aksesueshëm nga kushdo.

Më pëlqen të përfundoj me fjalët e Papa Françeskut:

“Të edukosh është të humanizosh, është ta bësh njeriun plotësisht njeri... Prandaj, vepra e edukimit të një fëmije është një vepër e vërtetë shoqërore, sepse do të thotë ta formosh atë në marrëdhënie me të tjerët, në respekt për të tjerët, në bashkëpunim për një qëllim të përbashkët, ta formosh atë në përgjegjësi, në ndjenjën e detyrës, në vlerën e sakrificës për të mirën e përbashkët... është të formosh njerëz të lirë dhe të mëshirshëm... dhe të transmetosh tek të rinjtë një formim pozitiv në lidhje me emocionet dhe jetën afektive; t'i mbrosh ata nga kërcënimet si bullizmi, alkooli, duhani, pornografia, video lojërat e dhunshme, lojërat e fatit dhe drogat". Faleminderit.

+ *Angelo Massafra ofm*



DIAKONI NË SHËRBIM TË UNGJILLIT

Shugurimi diakonal i akolitit Martin Bleta

Zoti i shpërndan gjithmonë dhuratat e tij lirshëm në bashkësitë tona ku jetojmë dhe veprojmë, dhe normalisht sipas gjykimit: na takon neve t'i njohim ato dhe t'i shfrytëzojmë sa më shumë në jetën tonë personale dhe bashkësiore.



Të enjten më 7 dhjetor, 2024, në Katedralen Shkodrës, u shugurua diakon i Arqidioqezës së Shkodër-Pult nga duart e arqipeshkvit Imzot Angelo Massafra, seminaristi Martin Bleta. Me këtë rast, Zoti na siguroi se do ta pasurojë më tej Kishën Katolike në Shqipëri dhe në botë. Një shërbim i çmuar ky që mund të shprehet në shumë forma, sipas nevojave të bashkësisë, si në shpalljen e Fjalës së Zotit, ashtu edhe në shërbimin e të gjithëve dhe ku mbi të gjitha do të jetë dëshmia e thjeshtë dhe e përditshme e një ndjenje falënderimi që do të na bindë për mirësinë e dhuratës së marrë nga Kisha nënë. Kisha nuk e ka qëllimin e saj në vetvete sepse ajo nuk i shërben vetvetes, kuptohet vetëm në lidhje me mbretërinë e Zotit dhe në të njëjtën kohë në raport me historinë, se është me

njerëzimin në botë, dhe endet nëpër kohëra. Shërbesa e diakonatit është pjesë e vetë dhënies që Krishti i bën vetes me fuqinë e Shpirtit, i cili erdhi për të shërbyer dhe për të dhënë jetën e tij (krh. Mk 10, 45). Është pasojë e përngjasimit sakramental nëpërmjet karakterit të “shërbëtorit” të Krishtit. Duke zgjedhur shërbimin, madje edhe duke u shenjtëruar për shërbim, diakoni është i vendosur t'i përgjigjet thirrjes së Zotit për çdo ditë, duke e vënë veten në shërbim të Tij, të Ungjillit të tij dhe të Kishës, për përmbushjen e Mbretërisë: kjo i jep kuptim çdo momenti të jetës së tij. Prandaj, mënyra për t'u shërbyer njerëzve është që t'i shërben Atij, Ungjillit të tij, “misterit të tij të shpëtimit”.

Redaksia



LULËZUAN THIRRJET PËR JETËN FRANÇESKANE STIGMATINE

“Asgjë nuk është e pamundur për Zotin!” Lk 1, 37



Të falenderoj për besnikërinë tënde, o Hyji im.

Pas një kohe të gjatë pritje dhe vuajtje (1946-1991) me regjimin komunist, që përjetuan Motrat Stigmatine në misionin e tyre të heshtur e besnike ndaj Zotit, panë me sytë e tyre frytin e farës së mbjellur në vitet e largëta ku bënë të mendosh se *për Zotin asgjë nuk është e pamundur!* Në vitin 1993, atëherë kur ende rrënjët e fesë kishin jetë, lulëzuan thirrjet për jetën françeskane stigmatine. Kuvendit iu rikthye jeta bashkësiore, rimëkëmbja e misionit në popullin fisnik shqiptarë. Hyji i zgjodhi ato që deshi, u denjua ta pasurojë Kishën e vet me vajza të reja të cilat me pak njohuri por më zemër të ndezur guxuan të shkojnë pas Tij. Rrugët e Tija janë të ngushta e nuk ishte aq e lehtë të rivendosnin themelet e jetës rregulltare me plagët e së kaluarës, me lirinë e besimit, me shpresën e së ardhmes. Në Shkodër, Kuvendi i hapi dyert duke pritur gjithnjë thirrje të reja, nevojitej të rifitonin dije e pjekuri fetare, profesionale e njerëzore. Kështu i dhanë fillim ecjes së tyre në shtëpinë e formimit në Shirokë. Shpirti i Shenjtë që ripërtërinë dhe gjallëron, i kishte mbush këto bija me gëzim e thjeshtësi ashtu si i ka hije përshtetërisë françeskane. Ushqimi i tyre kryesor ishte dëshmia e gjallë e motrave shqiptare, tashmë të moshuara, mbështetja e motrave misionare si dhe vet populli ynë i dashur dhe i etur për Zotin. Pasi koha e kaluar e (regjimit) kishte zhveshur vendin tonë, e kishte bllokuar nga çdo burim zhvillimi, varfëria materiale dominonte kudo. Motrat nuk u rezervuan kurrë nëpër fshatra e përreth: Shirokë, Obot,

Nënshatë, Hajmel, Pistull, duke jetuar në mes njerëzve për njerëzit, duke bashkëndarë atë që kishin, por sidomos gjenin kohë për lutje, vizita ndër të varfërit dhe shërbime të ndryshme në bashkësi e famulli. Me 8 dhjetor 1998, ditën e festës së Zojës së Papërlyer, në Kishën e Shën Rrokut në Shirokë, bëjnë Kushtet e Para Rregulltare në duart e Eprores Gjenerale Mt Anna Fiorentino. Në këtë Kishë ku ende nuk kishte dyer as dritare dhe muret ishin shumë të degraduara nga “torturat” që edhe ajo pësoi; kremtoi Meshën e Shenjte Shkëlqësia e Tij Imzot Angelo Massafra OFM, në praninë e shumë besimtarëve shirokas e familjarë të ardhur. Ndërsa, sot i jemi mirënjohëse Hyjit për besnikërinë e tij për të cilën kremtuam këtë jubile për 25 vjetorin e Jetës së Kushtuar të motrave tona: *Mt Tereza Ferra, Mt Hanë Gjollaj, Mt Marjeta Lushi, Mt Dukata Radoja*. Me 8 dhjetor në Kapelën e Kuvendit të Motrave Stigmatine, Imzot Angelo Massafra celebroi Meshën e Shenjtë në shenjë falenderimi Hyjit duke kujtuar se Zoja Mari edhe pse nuk e kishte të qartë përshëndetjen e Engjëllit Gabriel, iu besua vullnësës së Zotit duke shprehur “U bëftë me mua siç the Ti”. Ajo është Nëna jonë e ne jemi të sigurt se do të na shoqërojë gjithmonë e do të na udhëheqë pas Birit të saj. Çdo ditë është një fillim i ri për të vazhduar misionin që Hyji na beson: dashurinë për Zotin dhe shërbimin ndaj vëllezërve më të varfër, për nder e lavd të emrit të Tij.

*Motrat Stigmatine
Shkodër, 08/12/2023*



RESTAUROHET KISHA E ARBËRIT MONUMENT KULTURE E HISTORIE

Mërq, Lezhë më 18/11/2023



Në përmbylljen e punimeve të Kishës së Gjon në Mërq të Lezhës, Kisha e Kuvendit të Arbrit, si e tillë shumë-shekullore që mban brenda mureve të saj historinë e racës tonë, u bë përrurimi i përfundimit të punimeve restauruese, frutë i një punë nga muaj maj 2022 e deri me sot.

Në këtë vend të shenjtë 320 vjet ma parë u mblodh Kuvendi Arbnit, nën kujdesin e Papës shqiptar Klementit XI, Albanit. Me këtë rast, ishin të pranishëm Kryepeshkvi i Tivarit dhe Administrator i Dioqezës së Kotorrit Imzot Rrok Gjonllëshaj, Ipeshkvi i Lezhës Ottavio Vitale, Ipeshkvi i Kosovës Imzot Dodë Gjergji, Kryepeshkvi i Shkodrës Imzot Angjelo Massafra dhe kryetar i Konferencës Ipeshkvore, si dhe dy ipeshkvit në pension: Mons. Zef Gashi dhe Ilia Janjiq, Konsullit të nderit të Austrisë, Gjergj Leqejza. Këtë kremte e nderojnë ardhja e mysafirëve nga Kotorri (Mali i Zi) në krye me

famullitarin e vendlindjes së Zmajeviqve, famullitari i Perastit don Sreçko Majiq, titullar fetar nga Kotorri, priftërinj nga Kosova e Shqipëria, Kryetari i Bashkisë Lezhë, Pjerin Ndreu, zyrtarë e intelektualë nga rajoni.

Ceremonia e përrurimit nisi me përshëndetjen e famullitarit, dom Elton Margjeçi i cili ndër të tjera tha:

“Më lejoni t'u përshëndes të gjithëve për praninë tuaj.

Falënderoj nga zemra dom Nikë Ukgjinin i cili me vullnet të mirë ndërmori restaurimin e kësaj kishe, Monument kulture e historie. Faleminderit nga zemra në emrin tim dhe të gjithë famullisë sonë. Falënderoj të gjithë ata persona bujarë që kanë kontribuar qoftë për restaurimin e kishës qoftë për organizimin e kësaj dite.”

Më pas u bë bekimi i Altarit si dhe i shtatoreve të Papa Klementit si dhe të Vinçenc Zmajeviq nga



ipeshkvi i vendit Imzot Ottavio Vitale dhe kryepeshkvi i Tivarit Imzot Rrok Gjonlleshaj, u mbajtën edhe fjalët e rastit ku u vlerësua puna e mirë organizative e priftit të përkushtuar në ruajtjen e vlerave të veprave të kultit, Dom Nikë Ukgjini.

Mons. Ottavio Vitale Ipeshkëv i Lezhës tha:

“Jam shumë i lumtur të jem këtu i pranishëm në këtë përvjetor të Koncilit të Arbrit dhe në përfundim të punimeve të ndërmarra në këtë tempull.

Më lejoni të falënderoj në mënyrë të veçantë don Nikë Ukgjinin për vullnetin e tij të mirë për të rikonstruktuar këtë kishë, për t'i kthyer dinjitetin e saj qoftë si tempull qoftë edhe si objekt që mbart në vete vlera të mëdha historike dhe kulturore. Kjo kishë ka qenë vendi nga ku është organizuar e mbarë kisha e trojeve shqiptare pas mundimeve dhe vuajtjeve të mëdha për shkak të pushtuesve dhe jo vetëm.

Ishte e nevojshme ndërmarrja e një Koncili për të riorganizuar kishën Shqiptare dhe ajo çka më bën krenarë si ipeshkëv i Lezhës është fakti që në dioqezën tonë e kemi këtë kishë që është dëshmitare e shumë vendimeve të marra nga ipeshkvijtë pjesëmarrës dhe mund të them se jam falënderues atyre për punën e kryer pasi ato vendime nuk vdesin kurrë edhe pse gjithmonë ka gjëra që ndryshojnë”.

Fjalën e rasti e mori dhe famullitari i Perastit nga Mali i Zi, don Sreçko Majiq, i cili në emër të vendlindasëve të Vicko Zmjeviqi, falënderoj për organizimin e këtij takimi dhe ndërtimin e shtatores të kryepeshkvit të Tivari i cili la vepra të mëdha në favor të shqiptareve nga emërimi i tij në Tivar 1701-1713 e deri në mbarim të jetës së tij në Zarë (1713-1745).

Ipeshkvi i Kosovës, Imzot Dodë Gjergji, shprehu kënaqësinë që merr pjesë në këtë gëzim të kësaj dite. Ai rikujtoi momentet e bukura me popullin e Mërkisë dhe Kallmetit derisa ishte famullitar në këto zona në vitet 1994 – 2000, kur dhe bëri restaurimin e parë të Kishës së Kuvendit të Arbrit në vitin 1996. Ai në veçanti përmendi bashkëpunëtorin e tij të ngushtë Prend Jak Shtjefni i cili ka vazhduar të mbetet besnik i Kishës së Mërkisë edhe gjatë punës që ka bërë dom Nika gjatë gjithë kësaj kohe.

Përsëndeti edhe kryebashkiaku i Lezhës z. Pjerin Ndreu. Ai me superlativa vlerësoi bashkëpunimin me kishën katolike e veçanërisht me

Dom Nikën në këtë objekt si dhe objekte të tjera mesjetare, tashmë të restauruara si kisha e Balldrenit dhe ajo e Pllanës si dhe promemoria e Gazullorëve në Dajç të Zadrimës.

Fjalën përsëndetëse e mbajti ideatori dhe realizuesi i kësaj sipërmarrje kaq të rëndësishme dom Nikë Ukgjini. Ndër të tjera tha:

“Të nderuar shkëlqesi autoritete kishtare, nga Shqipëria, Mali i Zi e Kosova, autoritete të qeverisjes lokale, studiues të punës artistike,





donatorë të ndryshëm nga brenda dhe jashtë, dhe dashamirës të këtij kremtimi! Me ardhjen e demokracisë në mars të viti 1991, Kisha katolike si pjesë e këtyre vuajtjeve të këtij populli, me këtë rast filloi edhe ajo ringjalljen e saj. Meshtarët përpos

punës intensive baritore, ju desh të merreshin edhe më ringritjen e mureve të rrënuara të disa objekteve të kultit. Kështu ndodhi edhe me Kishën legjendare të Kuvendit të Arbrit, e cila gjatë kohës së komunizmit kishte degraduar së tepërmi. Duke qenë të bindur se kemi bërë një punë të vlefshme për ungjillëzimin kulturorë dhe shtuar një vlerë të madhe në trashëgiminë tonë Kulturore Kombëtare, dëshiroj të falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët, donatorët si dhe firmën e Filip Jakut.

Do përfundoja me parafrazimin e fjalëve të ungjillit: Sa është mirë kur vllëzërit jetojnë e punojnë së bashku”.

Në pjesën e dy të kësaj feste të rrallë, aktivitetin e hijeshoi edhe një koncert festiv i organizuar nga Qendra Fëmijëve në Bashkinë Lezhë.

Nga fjala e dom Nikë Ukgjinit:

Ky përurim vjen pas takimit shkencor të mbajtur në Kotorr të Malit të Zi, më dt. 17 nëntor, për kontributin e Arqipeshkvinjve të Tivarit, Andria dhe Vicko Zmajeviq, ndërsa sot dt. 18. nëntor, gjendemi në Kishën legjendare të Shën Gjjonit, e





cila para 320 viteve me dt. 14 -15 janar, mikriti barinjtë shpirtërore nga të gjitha trevat arbërore, të mbledhur për të kuvenduar për fatin e mëtejshëm të shqiptarëve të cilëve u rrezikohet së tepërmi, ekzistenca nga dhuna e egër osmane.

Ishte imzot Vicko Zmajeviq, Arqipeshkëv i Tivarit, kur papa Klementi XI Albani, nga i cili gufonte gjaku arbëror, i urdhëroi të besuarit e tij, që në emrin e Kishës së përbotshme, t'i bëjë tok arbërorët, që të kujdesën me të gjitha forcat për ringjalljen e jetës fetare të popullit, e të punojnë për ripërtëritjen, rritjen e klerit, për lirinë fetare e të popullit dhe hapjen pranë kishave të sa më shumë shkollave shqipe.

Në Aktet e Kuvendit të Arbënit, të cilat u botuan në latinisht e shqip në vitin 1706, nga Imzot Zmajeviqi, ftohet kleri katolik shqiptar, përkundrejt torturave nga pushtuesit, të qëndrojnë pranë në gazmende e në vaj pranë popullit të vet, që do ishte një investim i duhur dhe një paraprijë e rilindjes sonë kombëtare.

Në vitet e komunizmit përkatësisht mbas vitit 1967 ky objekt kulti me vlera të larta patriotike e kombëtare u kthye fillimisht në stallë bagëtish e më pas në magazinë drithërash. Më pas u rrëzua faqja ballore e murit si dhe u shemb çatia.

Restaurimi dhe ndërtimi i murit ballor e atij fundor dhe çatisë u bë në vitin 1996, falë për kujdesit të famullitarit të atëhershëm të kësaj zone, dom Dodë Gjergjit, i cili do shprehej se: *“unë e bana punën teme, por do vijë koha kur prap do vihet dorë mbi këtë objekt, për rikthimin në identitet sa ma të sakte të tij fillestar”*.

Sot i gëzohemi frytit të një pune shumë të lodhshme, pothuajse dy vjeçare e filluar në prill



2022, me meremetimin, ndërtimin, sistemimin e brendshëm të kishës dhe ambientit të jashtëm të saj. Ky ambient ka fitue vlerën e dyfishtë me vendosjen e dy figurave qendrore të organizimit të këtij Kuvendi Arbëror, Papa Klementit XI Albani dhe Vinçenc Zmajeviq, të cilët janë përjetësuar në shtatore guri, në shenjë kujtese e frymëzimi për brezat e rinj.

Në këtë sipërmarrje kontribuan Bashkia e Lezhës për ndërtimin rrugës dhe punimeve të tjera, miku i kulturës afaristi Gjergj Leqejza dhe donatorë të tjera nga vendi dhe nga jashtë vendit, si Amerika e Zvicra të cilët ishin prezent me delegacionet e tyre.

Duhet veçuar donatorët e shtatoreve, Ilir Vatë Biga për ndërtimin e shtatores së Papa Albanit që kishte ardhë veçmas prej NewYorkut, gjithashtu edhe dioqezat e Tivarit, Kotorrit, Zarës dhe Nikollë Shabani për shtatoren e Zmajeviqit”.

Në fund të faljes së tij dom Nika do të shprehej: *“Këtu punime të bukura për sy e për vesh nuk do të ishte realizuar me suksese pa ndihmën e grupit studimore e artistik. Grupi i punës: ark. Aleksandër Jushi me familje; inxh. Sokol Gazulli; skulptori Sadik Spahia; piktori Vasil Diamanti e konsultorëve të tjerë të heshtur. Me këtë rast do veçoja edhe skulptorin e rij, Ervis Gjini - Kovaçi i cili dhuroi dhe realizoi simbolin madhështor të Kuvendit të Arbrit të vendosur në oborrin e kësaj Kise”*.

Në fund mund të themi së ky inaugurim me përmasat që kishte, duke i mbledhur krerët e të gjitha trevave të Kishës Katolike, nga Kotorri, Tivari, Shqipëria e Dardania e hershme, mund të quhej lirishtë një Kuvend i dytë i Arbrit.

Përgatiti: Ndoc Shaben
Marrë nga gazeta “Dielli”,
New York, 22. Nëntor 2023.



"2000 VJET KRISHTËRIM TË SHQIPTARËT"!



Në mjediset pranë Hotelit të Gjuetisë, në Ishull-Lezhë, më dt. 2 dhjetor 2023, është organizuar promovimi i librit "2000 VJET KRISHTËRIM TË SHQIPTARËT" mes miqsh të mirë studiues nga Kosova e Shqipëria e diaspora.

Bëhet fjalë për një botim shumë cilësor me 36 punime, ku spikasin historianë evropianë më shumë reputacion si: Noel Malcolm, Robert Elsie, Peter Bartl, Antonio Bellusci, John McCaffrey, Konrad Clewing, Ercole Lupinacci, Odile Daniel e Peter Markus, por edhe emra të njohur të botës akademike shqiptare, si: Jahja Drançolli, Mark Krasniqi, Kristo Frashëri, Imzot. Mark Sopi, Ymer Jaka, Ramadan Sokoli, Gjergj Frashëri, Nikë Ukgjini, Nue Oroshi, Bejtullah Destani, Bardhyl Demiraj etj.

Këto 36 studime janë produkt i Simpoziumit të madh shkencor, që është mbajtur më 5 dhe 6 shtator të vitit 1998 në qytetin Arbon të Zvicrës. Botimi i këtyre materialeve në një vepër të plotë është bërë i



mundur nga Z. Kristë Coli, inicues dhe kryetar i këshillit organizativ të këtij simpoziumi dhe Z. Ahmet Asani, anëtar i këshillit botues e bashkëkryetar i simpoziumit të vitit 1998; pastaj Alfred Beka, drejtor i shtëpisë botuese "Jakup Ceraja" dhe Nexhat Haziri anëtar i këshillit botues.

Krishterimi në këtë libër nuk trajtohet si besim, si doktrinë, por trajtohet si qytetërim, si normë morale, e si kulturë. *"Libri që e kemi këtu trajton një moment me shumë domethënie për kombet e dy shteteve tona, Jubileun e 2 mijë vjeçarit të krishtërimit të shqiptarëve"* u tha në paraqitjen e librit.

Në hapje të aktivitetit fjalën e mori Ipeshkvi i Lezhë, Mons. Ottavio Vittale i cili vlerësoi kontributet e studiuesve për të nxjerrë në pah historinë e kombit shqiptar.

Kristë Coli, kryetar i këshillit organizator të simpoziumit ndërkombëtar falenderoi pjesëmarrësit në këtë event, vlerësoi punën e madhe në organizimin e këtij simpoziumi si dhe bashkëharmonizimin e grupit të punës në botimin e librit i cili në të ardhmen do të botohet edhe në gjuhë të tjera të botës.

Ndoc Shaben





Halil Xhubran

JEZUSI, BIRI
I NJERIUT

Gjakovë, 2008



Don Anton Uka

ETIKA E SYÇELTËSISË

DRITA
Prishtinë 2023



2000 VJET KRISHTËRIM
TE SHQIPTARËT

JAKUP CERAJA
Prishtinë, 2023

KUMBONA E SË DIELLËS
revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult
Tirazhi: 100 kopje
Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)
Parapagimi vjetor 600 lekë
(Evropë: 12 Euro)
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: www.kishakatolikeshkoder.com
Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
Sheshi "Gjon Pali II"
Shtypur në eleven studio - www.11stud.io

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXVI, nr. 11/12 (573-574) Nëntor - Dhjetor 2023